

PROGRAMI I PUNËS

i kandidatit për Rektor

të

Universitetit të Tetovës

për periudhën 2023 - 2026

Prof. dr. Bashkim Ziberi

Kontakt:

email: bashkim.ziberi@unite.edu.mk

Tel: 076 295395

Tetovë, 2023

Programi i punës së kandidatit për rektor të Universitetit të Tetovës në periudhën ndërmjet viteve 2023 – 2026

Historia e popullit shqiptar në Republikën e Maqedonisë së Veriut përshkruhet nëpërmjet një lufte të vazhdueshme për të mbijetuar në aspektin kulturor, gjuhësor, shoqëror dhe arsimor. Një nga shtyllat kryesore të luftës sonë të vazhdueshme për mbijetesë ka qenë, është dhe do të jetë padyshim arsimi. I zhvilluar në mënyrë jo të barabartë ndërjmet popujve në Maqedoninë e Veriut ndër dekada, ka qenë vazhdimisht burim i fërkimeve dhe konflikteve ndëretnike.

Veçanërisht pas pavarësimit të Maqedonisë së Veriut të viteve të 90-ta, nevoja për arsimim dhe pavarësim arsimor të shqiptarëve në Maqedoni bëhej çdo ditë e më eminente. Të gjendur para një sfide shekullore për edukim dhe arsimim në gjuhën amëtare, intelektualët dhe popullata shqiptare ideuan dhe realizuan një ëndërr të kahmotshme të popullit shqiptar në këto treva dhe themeluan Universitetin e Tetovës.

Historia e Universitetit të Tetovës është e dhimbshme, me sakrifica njerëzore dhe kontribut të jashtëzakonshëm të popullatës shqiptare dhe të klasës intelektuale në krye me Rektorin historik të saj Prof. dr. Fadil Sulejmani, e që zgjati deri në zyrtarizimin e tij në vitin 2004. Ky zhvillim unik i Universitetit të Tetovës nga ana tjetër na bën të mburremi si popull, sepse realizuam ëndrrën shekullore për arsim sipëror në gjuhën shqipe. I konceptuar për të plotësuar nevojat e popullit shqiptar në Maqedoni ndër të tjera për ndërtimin e kuadrove arsimore nga niveli parashkollor e deri tek ai universitar, shpejt u zhvillua në një qendër të rëndësishme për arsimimin e shqiptarëve edhe jashtë territorit të Maqedonisë së Veriut.

Sot në prag të 29 vjetorit të themelimit të tij, Universiteti i Tetovës është i mishëruar me zhvillimin ekonomik, industrial, shoqëror dhe akademik të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut. Si qendër e rëndësishme arsimore-

Programi i punës së kandidatit për rektor të Universitetit të Tetovës në periudhën ndërmjet viteve 2023 – 2026

shkencore Universiteti i Tetovës hapëron drejt një institucioni me një rritje të vazhdueshme në krijimin e kuadrove profesional të fushave të ndryshme, të kapaciteteve arsimore me hapjen e fakulteteve dhe programeve të reja studimore, në rritjen e kapaciteteve shkencore me laboratorë të fushave të ndryshme, me një infrastrukturë të zhvilluar, si dhe me një rrjet të gjërë partneritetesh dhe bashkëpunimi me Universitetet simotra anë e mbanë botës.

Vizioni dhe misioni i Universitetit të Tetovës do të vazhdojë të jetë sigurimi i një ambienti cilësor për studentët si në aspektin intelektual, ashtu edhe në atë profesional dhe njerëzor, duke përgaditur kuadro profesional dhe shkencëtar që do të bëjnë ballë sfidave të kohës së sotme, të zhvillimeve teknologjike dhe inovative të një bote ku paraprijnë globalizmi, digjitalizimi dhe inteligjenca artificiale. Me një qasje inovative, gjithpërfshirëse të përqëndruar në vlerat njerëzore dhe profesionale, me fokus zhvillimin e kapaciteteve hulumtuese, Universiteti i Tetovës do të vazhdojë të jep kontributin e tij të çmuar në përgatitjen e mësuesve, profesionistëve në bazë të kërkesave të tregut të punës, shkencëtarëve që janë konkures në qendrat kërkimore shkencore në të gjithë botën, pra në mirëqenien ekonomike, shoqërore si dhe vlerat kombëtare të popullit tonë dhe shoqërisë në përgjithësi.

Programi i punës së kandidatit për rektor të Universitetit të Tetovës në periudhën ndërmjet viteve 2023 – 2026

I nderuar staf akademik i UT-së,
Të dashur studentë,

I nxitur nga ndjenja e përgjegjësisë, kapacitetet e mija intelektuale, afirmimi im ndërkombëtar dhe dëshira për të kontribuar në zhvillimin e përgjithshëm të UT-së si institucion kryesor në sferën e arsimit sipëror dhe kërkimit shkencor për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, marr kurajon të kandidoj për postin e *Rektorit të Universitetit të Tetovës*.

I lindur në Radiovcë të Tetovës, shkollën fillore e kam kryer në vendlindje, për të vazhduar në Gjimnazin e Tetovës, që herët u ballafaqova me diskriminime në fushën e arsimit, duke mos pasur mundësi të vazhdoj shkollimin sipëror në gjuhën shqipe në vend, rrugëtimin tim e vazhdova në Tiranë në drejtimin e Fizikës 5 vjeçare ndër 11 studentët më të mirë të gjeneratës.

Pas një pune gjashtë mujore si asistent në Universitetin e Tetovës, nga marsi i vitit 1999 vazhdova studimet pasdiplomike në Universitetin e Lajpcigut në Gjermani dhe në vitin 2001 fitova thirrjen Magjistër i Shkencës në Fizikë. Pas kësaj, rrugëtimi im vazhdoi si punonjës shkencor në Institutin për modifikime sipërfaqësore në Lajpcig dhe në të njëjtën kohë doktorant në Fakultetin e Fizikës të Universitetit të Lajpcigut, ku në nëntor të vitit 2006 mora thirrjen Doktor i Shkencave në Fizikë. Si punonjës shkencor në Institut, nga mesi i vitit 2010 vendosa që së bashku me familjen të kthehem në vendlindje, për të dhënë kontributin pikërisht në Universitetin Shtetëror të Tetovës, ku vazhdoj edhe sot e kësaj dite në rolin e profesorit ordinar në departamentin e Fizikës.

Duke qenë ithtar i zhvillimit të vazhdueshëm profesional me idenë që shkencëtari dhe profesori universitar duhet vazhdimisht të vrapojë pas risive shkencore, profesionale, inovative, pra të ushqehet me njohuri të reja, në vitin

Programi i punës së kandidatit për rektor të Universitetit të Tetovës në periudhën ndërmjet viteve 2023 – 2026

2018 si bursist Fulbrajt i qeverisë së SHBA-së për 10 muaj qëndrova në Fakultetin e Mjekësisë së Harvardit, gjegjësisht në Institutin për hulumtimin e kancerit Dana-Farber si dhe në spitalin Brigham & Womens.

Ky përshkrim i shkurtër i rrugëtimit tim profesional, me një përvojë ndërkombëtare mbi 12 vjeçare duke kombinuar atë me punën time mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës, si përgjegjës i katedrës së fizikës nga viti 2010-2016 dhe udhëheqës i zyrës për shkencë dhe inovacion të UT-së në vitet 2014-2017, më jep të drejtën morale dhe profesionale për të kandiduar për postin e Rektorit të UT-së.

Sot më shumë se çdo herë zhvillimi shoqëror dhe institucional lidhet ngushtë me bashkëveprimin dhe rrjetëzimin me institucionet simotra në rajon dhe më gjerë, veprime të cilat kërkojnë përvojë dhe njohje të proceseve, sistemeve të punës dhe komunikimit të ndërsjellë. Një përvojë e tillë ndërkombëtare më lejon të bëj krahasime të sistemeve të ndryshme të funksionimit të arsimit sipëror dhe hulumtimit shkencor në mënyrë që të ndërtojmë institucione me një zhvillim të qëndrueshëm, me standarde të larta dhe parametra matës jo vetëm në nivel kombëtar, por bazuar edhe në udhëzimet e bashkimit Evropian. Nxjerrja e kuadrove profesionale të aftë për të konkuruar në tregun e punës brenda dhe jashtë vendit është një sfidë e vazhdueshme e sistemit tonë arsimor.

Rezultatet nga testimet ndërkombëtare dhe rangimet e universiteteve tona tregojnë se ne kemi nevojë për përmirësim të vazhdueshëm drejt sistemit edukativo-arsimor më cilësor që do të ndryshonte perceptimin për vendin tonë dhe do vinim në nivel të barabartë me institucionet arsimore evropiane.

Një element i rëndësishëm i jetës universitare e që ka ndikim të madh në rangimin e universiteteve janë punimet shkencore që lidhen ngushtë me punën kërkimore-shkencore, gjegjësisht me infrastrukturën dhe kapacitetet laboratorike

Programi i punës së kandidatit për rektor të Universitetit të Tetovës në periudhën ndërmjet viteve 2023 – 2026

e njerëzore për menaxhim me pajisje të tilla. Nga ana tjetër puna kërkimore-shkencore kërkon aplikime në projekte nacionale dhe ndërkombëtare për sigurimin e fondeve dhe në të njëjtën kohë bashkëpunim me kolegët brenda dhe jashtë vendit që do ta ngriste peshën e universitetit në arenën ndërkombëtare dhe do të ndikonte në rritjen e cilësisë në punën kërkimore-shkencore, duke sjellë në të njëjtën kohë pajisje dhe buxhet shtesë për Universitetin e Tetovës.

Për të arritur një nivel të tillë zhvillimor duhet që fokusi kryesor të jenë studentët dhe stafi akademik.

Liria akademike e stafit universitar do të jetë në themel të programit zhvillimor, duke vënë në pah shkathtësitë dhe arritjet individuale të çdonjërit nga ne. Pjesë e këtij programi do të jetë edhe infrastruktura në shërbim të studentëve siç janë: digjitalizimi i shërbimit studentor, bibliotekat, hapësirat shtesë për rekreacion dhe mësimi interaktiv, konviktet, mensat, laboratorët etj. Pra, është më se i nevojshëm një ambient ku studentët do ta ndjejnë veten pjesë integrale të përditshmërisë së tyre për periudhën studimore dhe pas saj.

Për një transformim të tillë të infrastrukturës universitare nevojitet padyshim një administratë e përgatitur mirë si në aspektin profesional, ashtu edhe në atë etikë dhe njerëzor, e cila arrihet nëpërmjet trajnimeve të ndryshme, veçanërisht në kohën kur të gjitha shërbimet digjitalizohen.

Ligji i arsimit të lartë që rregullon formën e funksionimit të universiteteve u siguron atyre autonomi të gjërë në mënyrën e organizimit të jetës universitare nëpërmjet statutit dhe rregulloreve të ndryshme të cilat ne duhet ti përpilojmë në formë të tillë që nxisin konkurrencën, vlerësojnë kontributin individual të secilit prej nesh, si dhe punën ekipore të punonjësve shkencor, stimulojnë zhvillimin dhe trajnimin e vazhdueshëm, shpirtin inovativ si të stafit akademik ashtu edhe të atij teknik dhe administrativ, e në veçanti të studentëve.

Programi i punës së kandidatit për rektor të Universitetit të Tetovës në periudhën ndërmjet viteve 2023 – 2026

Rregullimi normativ i Universitetit të Tetovës duhet të ketë në qendër të vëmendjes studentët të cilët duhet nxitur, stimuluar dhe përkrahur në mënyrë aktive duke zhvilluar konkurrencën e shëndoshë të bazuar në vlera dhe arritje profesionale që do ti bënin ata kompetent dhe konkurues jo vetëm në vend, por edhe jashtë tij.

Element shumë i rëndësishëm është jeta studentore brenda hapësirës universitare, organizimi dhe aktivizimi i tyre jashtë auditorëve. Këtu duhet të punojmë të gjithë së bashku që ti adresojmë interesat dhe nevojat e studentëve në mënyrë që tu krijojmë atyre hapësirë të mjaftueshme veprimi ku çdonjëri prej tyre të jetë në gjendje të identifikojë shkathtësitë e tij/saj me qëllim të kontributit sa më të madh në shoqëri, të jenë pjesë e proceseve zhvillimore në shoqëri, që të kontribuojnë në ndërtimin e të ardhmes së tyre dhe të gjeneratave në vijim.

Kuptohet që ndërtimi i kapaciteteve të tilla kërkon para së gjithash infrastrukturë të zhvilluar, në një mjedis inklusiv në kohezion me mjedisin jetësor. Prandaj, pjesë e programit tre vjeçar padyshim që do të jetë edhe sigurimi i fondeve për ndërtimin e objekteve shtesë në kuadër të universitetit, veçanërisht të njësive akademike që më së shumti u nevojitet.

Investimet e tilla domosdoshmërisht nënkuptojnë rritjen e buxhetit të Universitetit si dhe përqindjes së investimeve në shkencë dhe arsimin e lartë, gjë që duhet bërë në forma dhe burime të ndryshme, pra jo vetëm nga buxheti i shtetit, por edhe nëpërmjet projekteve të ndryshme dhe partneriteteve publiko-private. Krijimi i politikave dhe normativit për financimin e universiteteve dhe hulumtimit shkencor është kërkesë imediate kundrejt organeve qeveritare dhe ne këtu do të jemi të gatshëm të japim kontributin tonë.

Sot universitetet në të gjithë botën janë çerdhe e gjenerimit të ideve inovative, të shpirtit krijues, të ndërmarrësisë dhe me këtë edhe gjenerues të

Programi i punës së kandidatit për rektor të Universitetit të Tetovës në periudhën ndërmjet viteve 2023 – 2026

vendeve të reja të punës, ku rol të veçantë luan krijimi i kompanive të reja “start up” si inkubatorë për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, industrial, teknologjik dhe shoqëror.

Duhe të bëhet revitalizimi i objekteve në pronësi të UT-së në qytetet ku nuk zhvillohen aktivitete mësimore shkencore. Si për shembull realizimi i mësimi joformal, kurse parapërgatitore për studentët e ardhshëm, apo qendër gravitimi për të rinjtë ku do të ofrohen aktivitete të ndryshme.

- Universiteti i Tetovës dhe zhvillimi strategjik:

Angazhim aktiv i stafit menaxhues të Universitetit dhe të njësive akademike në ndërtimin e politikave arsimore, ekonomik dhe shoqërore në tërësi.

Rol më aktiv të stafit akademik me mbështetjen e menaxhmentit në ndërtimin e strategjive, kutlivimin dhe konservimin e vlerave kombëtare, tradicionale dhe shoqërore.

Ndërtimi i strategjisë për zhvillimin e brendshëm të UT-së që ka për bazë rritjen e cilësisë në arsim, zhvillimin e kapaciteteve shkencore, ndërkombëtarizimin dhe thithjen e fondeve, veçanërisht të Bashkimit Evropian.

Karakteri unitar, si një njësi akademike e UT-së duhet të vazhdojë duke pasur në konsideratë se një pjesë e njësive akademike e kanë të vështirë të mbijetojnë si ta pavarura, por edhe të numrit gjithnjë në rënie të studentëve si pasojë e migrimit. Në të njëjtën kohë duhet krijuar hapësirë të mjaftueshme veprimi dhe një buxhet që çdo staf menaxhues i fakultetit, në bazë të specifikave të tyre, të jetë në gjendje të realizojë programin e vet.

Programi i punës së kandidatit për rektor të Universitetit të Tetovës në periudhën ndërmjet viteve 2023 – 2026

Krijimi i qendrës për digjitalizim, që do të jetë përgjegjëse për procesin e transformimit digjital të Universitetit me të gjitha njësitë e tij, në një sistem të integruar që do të thjeshtësonte dukshëm qasjen deri te të dhënat e nevojshme. Këtu do të përfshihen të gjitha veprimtaritë që kanë të bëjnë me mësimdhënien, punën kërkimore-shkencore, profesionale dhe administrative. Ndërtimi i një rrjeti modern të qëndrueshëm për transfer të shpejtë dhe të sigurtë të të dhënave është i domosdoshëm. Në qendër të transformimit digjital do të jetë edhe ndërtimi i një faqeje me qasje të brendshme (intranet), vetëm nga punonjësit e universitetit, që do të mundësonte komunikimin e ndërsjellë, shkëmbimin e të dhënave, shpalljen e lajmërimeve të ndryshme dhe shumë aktivitete në një formë të mbrojtur nga ndikimet e jashtme. Një platformë ku do të promovoheshin vlerat njerëzore dhe profesionale të punonjësve dhe të gjithë atyre që kontribuojnë në zhvillimin dhe promovimin e kampusit universitar. Një formë e tillë komunikimi është shumë efektive veçanërisht kur institucioni ka një shpërndarje të gjerë hapësinore.

Në kuadër të Universitetit do të krijohet qendra për transfer të teknologjisë, nxitjen e sipërmarrësisë dhe krijimin e start-up kompanive të cilat si modele eksperimentale do të përgaditen për tu lëshuar në tregun e lirë. Një qendër e tillë do të mundësonte një komunikim të vazhdueshëm me bizneset private dhe qendrat tjera brenda dhe jashtë vendit me qëllim promovimin dhe trajnimin e studentëve dhe përgaditjen e tyre për tregun e punës.

Krijimi i shoqatës alumni nga profesionistë të fushave të ndryshme, ish studentë të Universitetit të Tetovës është domosdoshmëri me përfitime të shumëllojshme. Një data bazë e tillë do të na ndihmojë të kemi të dhëna për shpërndarjen dhe suksesin profesional të ish studentëve tanë dhe në të njëjtën kohë krijojmë ura bashkëpunimi me studentët aktual. Gjithashtu këto të dhëna do na mundësojnë të mënjanojmë dobësitë eventuale të programeve studimore dhe metodave mësimore.

Programi i punës së kandidatit për rektor të Universitetit të Tetovës në periudhën ndërmjet viteve 2023 – 2026

Themelimi i instituteve në kuadër të njësive akademike të Universitetit është një domosdoshmëri në aspektin e rritjes së cilësisë në tërësi e në veçanti të forcimit të komponentes shkencore, teknologjike dhe inovative. Kjo do të ndikonte në qasjen dhe formën e komunikimit me partnerët ndërkombëtarë, do të rriste kapacitetet hulumtuese si dhe besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë në punën kërkimore shkencore. Institutet do të kenë specifikat e tyre në varshmëri nga roli dhe fushat shkencore që do të përfaqësojnë.

Në aspektin infrastrukturor Universiteti i Tetovës ka nevojë për investime kapitale (objekte) veçanërisht në njësi akademike të caktuara siç janë:

- Fakulteti i Shkencave Mjekësore,
- Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore,
- Fakulteti i Shkencave Aplikative,
- Fakulteti i Bujqësisë dhe Bioteknologjisë,
- Fakulteti i Arteve.

Vëmendje të veçantë do të kushtojmë ndërtimit të bibliotekës universitare që do të ketë rolin e një qendre mutlifunksionale, që përveç se leximore të shërbejë edhe për aktivitete të ndryshme kulturore dhe shoqërore, jo vetëm për komunitetin e kampusit universitar por edhe për shoqërinë në tërësi. Pjesë integrale e bibliotekës do të jetë edhe digjitalizimi i shërbimit dhe qasjes në sa më shumë revista dhe databaza shkencore ndërkombëtare.

Meqë stafi dhe studentët e UT-së pjesën më të madhe të kohës së tyre e kalojnë në hapësirat universitare, shërbimet ndaj tyre duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të barabarta për të gjithë. Këtu nënkuptohet krijimi i kushteve për lëvizje të lirë dhe shërbim dinjitoz për personat me nevoja të veçanta, ndërtimi i çerdhes për kujdes të fëmijëve deri në moshën parashkollore si për stafin ashtu edhe për studentët, me një orar fleksibil varësisht prej nevojës.

Programi i punës së kandidatit për rektor të Universitetit të Tetovës në periudhën ndërmjet viteve 2023 – 2026

Për projekte të tilla kapitale dhe infrastrukturore nevojitet buxhet shtesë, prandaj do të insistojmë në rritjen e fondeve për investime kapitale nga buxheti i shtetit, kurse një pjesë e projekteve do të realizohen me partneritet publiko-privat. Shembuj të tillë partneritetesh janë treguar shumë të suksesshme në vende të ndryshme të botës, e veçanërisht në SHBA.

Rritja e cilësisë në arsim

Studentët duhet të jenë fokusi kryesor gjatë konceptimit, krijimit, zhvillimit dhe zbatimit të të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me Universitetin e Tetovës.

- Ofertë akademike dhe programe studimore që përputhen me nevojat e tregut në të tre ciklet studimore.
- Evaluim i vazhdueshëm i programeve studimore duke i adaptuar sipas nevojave të tregut dhe në hap me zhvillimet inovative dhe teknologjike të kohës.
- Përfshirja e metodave të reja inovative në mësimdhënie.
- Transparencë në të gjitha hapat e vlerësimit të studentëve.
- Qasje të shumëllojshme të studentëve në materialet mësimore.
- Konsultime të vazhdueshme me stafin akademik.
- Qasje më konstruktive ndaj nevojave dhe kërkesave të studentëve.
- Oferta personale sipas nevojave të studentëve.
- Evaluimi individual dhe i vazhdueshëm i punës së stafit akademik
- Përmirësimi i kushteve materiale për mësim dhe punë në hapësirat universitare.
- Përfshirja e studentëve në aktivitetet shkencore, kulturore, sportive etj.
- Zhvillimi i metodave mësimore varësisht specifikave të programit studimor.

Programi i punës së kandidatit për rektor të Universitetit të Tetovës në periudhën ndërmjet viteve 2023 – 2026

- Zhvillimi dhe përforsimi i punës praktike si formë integrale e programeve studimore
- Nxitja e shpirtit konkurrues ndërmjet studentëve nëpërmjet programeve të ekselencës

Studentët kanë botën e tyre

Studentët duhet të kenë mundësi të organizojnë dhe rregullojnë vetë jetën studentore brenda kampusit universitar, por që mund të kishte ndikim edhe në shoqëri në tërësi.

- Pjesëmarrje aktive në organizimin e unionit studentor.
- Pavarësimi i unionit studentor.
- Krijimi i klubeve studentore në kuadër të fakulteteve dhe në varshmëri nga nevoja dhe interesat e studentëve.
- Nxitja e vullnetarizmit tek studentët nëpërmjet bashkëpunimeve me unionet dhe shoqatat studentore brenda dhe jashtë vendit.
- Ndihmesë në trajnimin e vazhdueshëm të tyre për format e organizimit dhe kontributin që mund të japin në shoqëri.
- Krijimi i hapësirës së veçantë për realizimin dhe kultivimin e jetës studentore.
- Pjesëmarrje aktive në vendimmarrje në të gjitha organet universitare.

Puna kërkimore shkencore në Universitetin e Tetovës

Ndërtimi i politikave dhe infrastrukturës për punë kërkimore-shkencore dhe profesionale është një nga shtyllat kryesore për matjen e cilësisë në arsimin e lartë, qasjes në fondet shtesë, ndërkombëtarizimin e universitetit, si dhe në zhvillimin e tërësishëm inovativ, teknologjik dhe ekonomik të shoqërisë. Këtu përfshihen:

Programi i punës së kandidatit për rektor të Universitetit të Tetovës në periudhën ndërmjet viteve 2023 – 2026

- Krijimi i infrastrukturës laboratorike studentore për çdo fushë shkencore në veçanti,
- Ngritja e infrastrukturës bazë për laboratore kërkimore-shkencore,
- Investime në laboratore kërkimore-shkencore bazike dhe aplikative,
- Krijimi i partneriteteve publiko-private në ndërtimin e laboratoreve sipas kërkesave të biznesit,
- Akreditimi i laboratorëve për kontrollin e cilësisë së produkteve,
- Krijimi i qendrës për transfer të teknologjisë,
- Krijimi i zyrës për mbrojtje të pronësisë intelektuale,
- Krijimi i një qendre për promovimin e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit,
- Mbështetje financiare për projekte hulumtuese dhe krijimin e mekanizmave për evaluim transparent dhe cilësor të tyre,
- Mbulimin e kuotizimit për botimet në revistat me faktor impakti,
- Mundësinë për qasje të lirë në data bazën e revistave shkencore si *Scopus*, *Web of Science* etj.
- Promovimin dhe mbështetjen financiare të punës individuale dhe artistike brenda dhe jashtë vendit,
- Vendosja e parametrave të promovimit dhe vlerësimit të kontributit të punonjësve kërkimor-shkencor,
- Krijimi i mekanizmave për etikë të mirë shkencore dhe mbrojtje të pronësisë intelektuale,
- Mbështetje teknike gjatë aplikimeve në projekte brenda dhe jashtë shtetit,
- Stimulimi material për aplikime në projekte brenda dhe jashtë vendit,
- Ndihmesë në realizimin e projekteve në formën e qëndrueshmërisë dhe funksionimit më afatgjatë,
- Autonomi të plotë në menaxhimin me projektet e fituara,

Programi i punës së kandidatit për rektor të Universitetit të Tetovës në periudhën ndërmjet viteve 2023 – 2026

- Trajnim të vazhdueshëm të stafit akademik mbi mundësitë e aplikimit në programin kornizë *Horizon Europe*, në veçanti të programeve specifike që kanë të bëjnë me ballkanin perëndimor,
- Financimi i Konferencave Shkencore (ndërkombëtare) për stafin akademik me qëllim zgjerimin e rrjetëzimit me kolegët anë e mbanë botës.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Sot në kohën e globalizimit, ndërtimi i i urave të bashkëpunimit, rrjetëzimi dhe ndërkombëtarizimi i universiteteve është më se i domosdoshëm për një zhvillim të qëndrueshëm në të gjitha segmentet e tij. Kjo është një nga shtyllat kryesore të promovimit dhe mbështetjes financiare edhe nga ana e Bashkimit Evropian nëpërmjet hapësirës hulumtuese evropiane (ERA).

Bashkëpunimi ndërkombëtar me institucionet kërkimore-shkencore dhe akademike do të bazohet në:

- Rifreskimin e marrëveshjeve ekzistuese,
- Intensifikimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me theks të veçantë vendet e Bashkimit Evropian,
- Konkretizimi dhe nxitja e bashkëpunimit nëpërmjet planeve konkrete të afatizuara,
- Shkëmbimi i studentëve dhe stafit akademik,
- Krijimi i programeve të përbashkëta, veçanërisht në master dhe doktorata,
- Organizimi i konferencave dhe simpoziumeve të përbashkëta,
- Vizitë qendrave të njohura kërkimore-shkencore në rajon dhe më gjerë,
- Rritje të mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik,
- Anëtarësimi i universitetit në organizmat ndërkombëtare dhe roli aktiv në to,

Programi i punës së kandidatit për rektor të Universitetit të Tetovës në periudhën ndërmjet viteve 2023 – 2026

- Nxitja e pejsëmarrjes në programet e bashkimit evropian Horizon Europe, ERASMUS+, COST, CEEPUS,
- Nxitja e bashkëpunimit dhe rrjetëzimit me institucionet arsimore shkencore jashtë hapësirës evropiane në veçanti me Shtetet e Bashkuara të Amerikës,
- Aplikimi në bursat si Fulbrajt, DAAD, Humboldt etj.

Programi i paraqitur më sipër është ndërtuar nga diskutimet ndër vite me kolegë brenda dhe jashtë vendit, nga sugjerimet e kolegëve në UT të cilëve u jam mirënjohës, si dhe nga përvoja ime e angazhimit profesional në vende dhe institucione të ndryshme, përfshirë këtu edhe komisionet dhe këshillat vendimmarrëse brenda dhe jashtë vendit. Kuptohet që një program i tillë është i hapur për sugjerime dhe ndërhyrje të cilat do të çonin në zhvillimin e tërësishëm të jetës universitare në UT.

Tetovë, 06.06.2023

I juaji,

Prof. Dr. Bashkim Ziberi